



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës



Plani për Investime
në Hapësirat e Hapura Publike
2016-2020
Komuna e Kamenicës

Plani për Investime
në Hapësirat e Hapura Publike
2016-2020
Komuna e Kamenicës

Ndërtimi i qyteteve gjithëpërfshirëse, të shëndetshme, funksionale, atraktive dhe produktive është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi në ditët e sotme. Pjesa më rëndësishme e enigmës për ta arritur këtë mund të qëndrojë në HHP-të të cilat me të drejtë konsiderohen si zemra të zonave urbane.

Falënderimet

Plani për mirëmbajtjen dhe plani për investime në hapësirat e hapura publike janë përgatitur nga grupi punues (GP) i komunës së Kamenicës, bartëse e të cilës është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues (GK), zyrtarët e projektit si dhe konsulentët lokalë dhe ndërkombëtarë, përgjegjës të projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation i financuar nga Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). GP dhe GK për hartimin e planit të mirëmbajtjes dhe planit të investimeve në hapësirat e hapura publike në komunën e Kamenicës kanë bërë identifikimin e hapësirave të hapura publike në terren si dhe planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre duke u bazuar në përvojën me komunat partnere lokale dhe në përvojën ndërkombëtare gjatë vizitës studimore.

Grupi Punues

1. **Faton Jakupi** – DShPAI, kryesues
2. **Hysen Jerliu** - DShPAI, anëtar
3. **Mehmet Thaçi** - DUPH, anëtar
4. **Ramush Ismajli** - DPKGj, anëtar
5. **Sami Morina** – DShPAI, anëtar
6. **Arsim Thaçi** – KShP, anëtar

Grupi Koordinues

1. **Begzad Sinani** – kryesues
2. **Bajram Dërmaku** – anëtar
3. **Faton Jakupi** – anëtar
4. **Ilir Kastrati** - anëtar
5. **Fadil Hoti** - anëtar
6. **Agim Shkodra** - anëtar

Ekipi përkrahës

1. **Bajram Shefkiu** - këshilltar lokal
2. **Teuta Jaha-Hoxha** - zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation
3. **Majlinda Jupolli** - zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation

Lista e shkurtesave:

DEMOS	Programi për Decentralizim dhe Mbështetje Komunave
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
KKK	Kuvendi Komunal Kamenicë
KK	Komuna Kamenicë
GQ	Grant Qeveritar
HHP	Hapësirat e Hapura Publike
PMHHP	Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike
PIHHP	Plani i Investimeve në Hapësirat e Hapura Publike
PZhK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PRRU	Plani Rregullues Urban
ZU	Zona Urbane
ZR	Zona Rurale
QPS	Qendra për Punë Sociale
DShPAI	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit
DUPH	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
DPKGj	Drejtoria për Pronësi, Kadaster dhe Gjeodezi
KShP	Komiteti për Shërbime Publik

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	9
1.1. Fushëveprimi i Planit të investimeve në HHP-të.....	10
1.2. Parimet udhëheqëse për investime në HHP-të.....	10
1.3. Dokumentet referuese për përgatitjen e PIHHP-së	11
2. Gjendja aktuale dhe analiza e investimeve kapitale ne HHP-të	11
2.1. Gjendja aktuale në aspektin e ofertës së HHP-ve sipas tipologjive.....	11
2.2. Gjendja aktuale - analiza e investimeve kapitale në HHP-të	13
2.3. Plani i investimeve në HHP për periudhën afatmesme 2016 – 2020.....	14
3. Vizioni, objektivat dhe strategjia e zhvillimit të HHP-ve	16
3.1. Synimet dhe objektivat specifike.....	17
4. Plani financiar	18
4.1. Supozimet kryesore në Planin financiar.....	18
4.2. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale (buxheti investiv), përfshirë fuqinë punëtore, transportin, ndërtesat, pajisjet, automjetet, etj.	18
5. Monitorimi dhe rishikimi	21
5.1. Plotësimi dhe revidimi i PIHHP-së	21
6. Plani i veprimit	22

Lista e tabelave

Tab. 1: Sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Kamenicës për tipologjitë e trajtuara në plan	11
Tab. 2: Investimet në HHP-të në qytetin e Kamenicës në zonën urbane dhe rurale - periudha 2013-2015.....	13
Tab. 3: Inv. e planifikuara në HHP-të në komunën e Kamenicës, zona urbane dhe rurale., periudha 2016-2018	14
Tab. 4: Projektet për investime kapitale	18
Tab. 5: Analiza e zotimit të buxhetit për mirëmbajtje dhe investime kapitale.....	19
Tab. 6: Rrjedha e parasë për IK për vitin 2016	19
Tab. 7: Rrjedha e parasë për IK për vitin 2017	20
Tab. 8: Rrjedha e parasë për IK për vitin 2018	20
Tab. 9: Formë tabelare – model i Pplanit të veprimit për investimet në HHP-të	23

Lista e figurave

Fig. 1: Hapësirat për rekreacion aktiv dhe pasiv	12
Fig. 2: Investimet e realizuara në HHP-të në periudhën afatmesme buxhetore 2013 -2015.....	14
Fig. 3: Investimet e planifikuara në HHP-të për periudhën afatmesme buxhetore 2016-2018.....	15
Fig. 4: Rrjedha e parasë – investimet 2016	19
Fig. 5: Rrjedha e parasë – investimet 2017	20
Fig. 6: Rrjedha e parasë – investimet 2018	20

1. HYRJE

HHP-të kanë padyshim rol të veçantë në përcaktimin e funksioneve kulturore, shoqërore, ekonomike, politike, dhe paraqesin vijat kryesore të portretit të vendbanimeve në përgjithësi. Tani, edhe tek ne, ato kanë filluar të trajtohen si elemente primare, treguese të statusit të vendbanimeve dhe të cilat në të vërtetë sigurojnë atributin e qytetit të zhvilluar dhe të planifikuar mirë.

Rëndësia e HHP-ve anashkalohet shpesh gjatë planifikimit të qyteteve, dhe për këtë ekzistojnë një sërë arsyes, si: mungesa e fondeve dhe burimeve financiare, perceptimi ende joadekuat i kapaciteteve dhe mundësive për t'i shfrytëzuar ato si tërësi hapësinore dhe si sisteme shumëfunksionale urbane, si dhe mungesa e iniciativave dhe mjeteve për angazhime publike.

Megjithatë, viteve të fundit dhe në përgjithësi në qytetet e Kosovës, përkundër zhvillimeve të pakontrolluara të ndërtimeve, ndoshta si një “anë pozitive e paradoksit” vërehen lëvizje “shpresdhënëse” edhe në krijimin dhe menaxhimin e HHP-ve, shpesh të nxitura me donacione nga qeveri të ndryshme nga Evropa dhe më tej. Në këtë kontekst, edhe qëllimi i projektit DEMOS, i financuar nga SDC dhe i cili po implementohet nga Helvetas Swiss Interccoperation është pikërisht nxitja e planifikimit dhe menaxhimit të HHP-ve si një shtytje kyçe për zhvillimin urban të qyteteve – komunave partnere.

Nga këto HHP të zhvilluara dhe të planifikuara mire, priten përmirësime në shfrytëzimin racional të tyre dhe në qasjen drejt shërbimeve themelore, pastaj ambiente të sigurt, stimulim i aktiviteteve ekonomike dhe i investimeve, promovim i vlerave kulturore dhe historike, ringjallje urbane dhe gjithë-përfshirje, etj.

Një ndër çështjet kyçe në planifikimin, krijimin dhe financimin sistematik në HHP-të paraqesin burimet e vogla buxhetore për investime kapitale në përgjithësi, dhe një qasje e sistemuar në këtë aspekt do t'i mundësojë qeverisjes komunale shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve aktuale, përfshirë qasjen drejt burimeve të jashtme të financimit. Një plan me prioritet të përcaktuara mirë do ta mundësojë përgaditjen e projekteve të reja si dhe zhvillimin dhe avancimin e HHP-ve ekzistuese.

Procesit të përpilimit të Planit të investimeve në HHP-të i prin grupi punues komunal, i ndihmuar nga grupi koordinues i cili përbëhet nga drejtorë dhe zyrtarë të lartë të drejtorive përkatëse, ndërsa informacionet e rëndësishme janë siguruar nga zyrtarë gjegjëse, nga ndërmarrjet publike, si dhe nga shoqëria civile dhe qytetarët të cilët janë nxitur në pjesëmarrje aktive duke dhënë ide, propozime, mendime, etj.

1.1. Fushëveprimi i Planit të investimeve në HHP-të

Plani i investimeve në HHP-të për komunën e Kamenicës si dokument afatmesëm bazohet në vizionin e qytetit, i cili parasheh arritjet afatgjata të komunës në fushën e planifikimit, një nga të cilat është ajo e HHP-ve, përfshirë parqet, hapësirat gjelbëruese natyrore, sheshet, terrenet sportive, varrezat, dhe hapësirat pranë objekteve kulturore-historike.

Në këtë kontekst janë hartuar dy plane, gjegjësisht, Plani i mirëmbajtjes së HHP-ve dhe Plani i investimeve në HHP.

Që të dy këto dokumente janë nxjerre nga një sërë burimesh, përfshirë ato në vijim:

- Vlerësimi i HHP-ve të qytetit nga ana e grupit punues;
- Dokumentet ekzistuese ligjore dhe këshilluese;
- Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban, 2013-202;
- Planet Detale, Urbanistike dhe Planet Rregullative, 1976-1981/200;
- Konsultimet dhe diskutimet publike me qytetarët dhe me institucionet lidhur me vizionin e qytetit.

Planet janë formësuar nëpërmjet punëtorive me drejtoritë gjegjëse komunale, nëpërmjet diskutimeve publike, përfshirë prezantimet para qytetareve, para grupit koordinues komunal dhe gjithashtu ato parashohin investimet sipas prioriteteve, afateve të planifikimit dhe të zbatimit, shpenzimeve vjetore dhe propozimeve për financim.

Rishikimi i të njëjtave mund të bëhet për çdo vit dhe në mënyrë empirike, duke u bazuar në vrojtimet gjatë realizimit të tyre në vitin paraprak, me parashikime të detajuara për vitin pasues.

1.2. Parimet udhëheqëse për investime në HHP-të

Investimet në planifikimin, rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të hapura publike bazohen në parimet vijuese:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm nëpërmjet qasjes integruese në planifikimin dhe realizimin e HHP-ve;
2. Zhvillimi i barabart dhe i njëtrajtshëm i territorit;
3. Shfrytëzimi racional i tokës me aplikimin e masave të rivitalizimit dhe rindërtimit urban dhe rural;
4. Shfrytëzimi racional i resurseve të parapërtitshme dhe shfrytëzimi optimal i atyre të ripërtitshme;
5. Harmonizimi me rregulloret dhe standardet vendore dhe evropiane në fushën e planifikimit dhe rregullimit hapësinor;
6. Pjesëmarrja e publikut dhe komunitetit;
7. Ruajtja e zakoneve dhe traditave, si dhe e tipareve specifike të rajoneve;
8. Koordinimi horizontal (ndërlidhja me territoret fqinje në nivel të rregullimit hapësinor dhe urban me qëllim të zgjidhjes së funksioneve dhe interesave të përbashkëta si dhe lidhjes dhe bashkëpunimit të pjesëmarrësve në planifikimin e hapësirave), dhe koordinimi vertikal (vendosja e ndërlidhjes së të gjitha niveleve të planifikimit dhe rregullimit hapësinor e urban, nga ai qendror, drejt atij regjional dhe lokal, si dhe informimi, bashkëpunimi dhe koordinimi mes iniciativave lokale, planeve dhe projekteve me planet regjionale dhe qëndrore).

1.3. Dokumentet referuese për përgatitjen e PIHHP-së

Plani i investimeve ndërlidhet me nevojat dhe kërkesat për HHP-të në zonën urbane dhe atë rurale, me kualitetin e jetës dhe në përgjithësi tenton t'i promovojë interesat e qytetarëve në komunën e Kamenicës. Disa nga dokumentet në kuadër të kornizës ligjore në të cilat është referuar përgatitja e këtij plani janë:

- i. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018
- ii. Plani Zhvillimor Komunal (PZhK), 2013-2023
- iii. Planil Zhvillimor Urban, 2013-2018
- iv. Planelt Rregulluese Urbane, të vitit 2009
- v. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e RK / Prishtinë: viti III / Nr. 28 / 04 qershor 2008.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018, e aprovuar me 30 shtator 2015, i ka të parashikuara projektet për investime në të gjitha zonat e komunës. Në të vërtetë, projektet kapitale të cilat përmenden në të janë kryesisht infrastrukturë rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe objekte publike por jo edhe tipologji të HHP-ve për rekreacion pasiv apo aktiv të qytetarëve.

2. GJENDJA AKTUALE DHE ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE NË HHP-TË

2.1. Gjendja aktuale në aspektin e ofertës së HHP-ve sipas tipologjive



Me përditësimin e inventarit të HHP-ve, nga ana e grupit punues është konstatuar se oferta aktuale me 11.93 m²/ban. për parqe, gjelbërime, sheshe dhe terrene sportive për zonën urbane është përtej qëllimeve të synuara dhe gjendja e tanishme konsiderohet relativisht e favorshme në aspektin e mbulueshmërisë me HHP.

Për ilustrim, në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat e sipërfaqeve të HHP-ve për kokë banori dhe ky është rezultat i hapit të parë të ndërmarrë nga ana e grupit punues për evidentimin e hapësirave publike:

Tab. 1: Sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Kamenicës për tipologjitë e trajtuara në plan

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m ²	Nr. i banorëve	Sip. e HHP-ve në m ² /ban.
Parqe	15.004	8.918	1,70
Hapësira gjelbëruese	57.971	8.918	6,50
Sheshe	1.410	8.918	0,20
Terrene sportive	26.024	8.918	2,92
Lapidare dhe memoriale	5.988	8.918	0,67
Gjithsej në m ²	106.397	8.918	11,93

Fig. 1: Hapësirat për rekreacion aktiv dhe pasiv



Në Fig. 1 ofrohet paraqitja grafike e sipërfaqeve aktuale të HHP-ve në qytetin e Kamenicës dhe raporti i tyre në përqindje për tipologjitë el trajtuara në plan.

Me qëllim të ruajtjes së standardit ekzistues dhe pas vlerësimit nga grupi punues se gjendja e tanishme për disa nga hapësirat ekzistuese në zonën urbane nuk është në nivelin më të kënaqshëm, rekomandimet janë që investimet me prioritet së pari të orientohen në rivitalizimin dhe rindërtimin e hapësirave të degraduara (përmirësimi i cilësisë së hapësirave ekzistuese) para se të punohet në krijimin e hapësirave të reja publike. Në këtë kontekst, punimet në rivitalizimin e parkut të qytetit veç janë në realizim e sipër, ndërsa rivitalizimi edhe i dy hapësirave të tjera është i planifikuar për vitin 2017.


2.2. Gjendja aktuale - analiza e investimeve kapitale në HHP-të

Për ta pasur një pasqyrim të projekteve të realizuara, në tabelën 2 në vijim janë paraqitur të dhëna mbi investimet në HHP-të gjatë trevjeçarit të kaluar, ndaras për zonën rurale dhe për atë urbane:

Tab. 2: Investimet në HHP-të në qytetin e Kamenicës në zonën urbane dhe rurale - periudha 2013-2015

Nr. ren.	Emri i HHP-së/investimet e realizuara në rehabilitimin e hapësirave ekzistuese	2013	2014	2015	Burimi i investimeve
1	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhemirembajtja	2.952,00	-	-	KK
2	Rregullimi i fushave sportive në Shipashnicë dhe Dajkoc	21.770,00	-	-	KK/Grant Qev./Donac
3	Rregullimi i trotuareve	45.000,00	-	-	KK
4	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese	13.000,00	-	-	KK
5	Ndriçimi publik	45.000,00	-	-	KK
6	Fusha e sportit Kopernicë-Krilevë	32.200,00	-	-	KK
7	Rregullimi i përroit të fshatit në Rogaçicë	10.000,00	-	-	KK
8	Rregullimi i rrethojave të varrezave në Rogaçicë	14.000,00	-	-	KK
9	Rregullimi i parkut në Topanicë	12.000,00	-	-	KK
10	Rregullimi i shtratit të përroit dhe i rrethojës së varrezave në Rogaçicë	23.768,00	-	-	
11	Rregullimi shtigjeve për këmbësorë dhe ndriçimi publik përgjatë lumit Krivareka	194.000,00	-	-	IOM
12	Rregullimi i trotuarit në Hodonoc	116.000,00	1.510,00	-	KK
13	Rregullimi i trotuareve në Hodonoc	-	1.700,00	-	KK
14	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhemirembajtja	-	26.000,00	-	KK
15	Ndriçimi publik i rrugëve në qytet dhe në fshatra	-	25.000,00	-	KK
16	Fusha e sportit Kopernicë-Krilevë	-	7.154,55	-	KK
17	Rregullimi i fushave të sportit në Shipashnicë e Poshtme dhe Dajkoc	-	14.409,00	-	KK
18	Fusha e sportit Kopernicë-Hodonoc	-	2.262,00	-	KK
19	Ndërtimi i shkallëve të arenës në platonë e kompleksit "K. Zeka"	-	2.830,40	-	KK
20	Përgatitja e terreneve sportive në lagjen "Malësia"	-	800,00	-	KK
21	Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese në qytet	-	26.000,00	-	KK
22	Përgatitja e hapësirave gjelbëruese tek ura e vjetër, Topanicë	-	19.990,00	-	KK
23	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	-	-	25.000,00	KK
24	Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese	-	-	30.000,00	KK
25	Rregullimi i shtratit të lumit në Berivojcë	-	-	204.000,00	IOM/KK
26	Ndërtimi i parkut tek QPS	-	-	22.139,18	MAPL
Gjithsej inv. të planifikuara në HHP-të sipas viteve:		529.690,00	127.656,00	281.139,20	-

Fig. 2: Investimet e realizuara në HHP-të në periudhën afatmesme buxhetore 2013 -2015



2.3. Plani i investimeve në HHP-të për periudhën afatmesme 2016 – 2020


Investimet prioritare në HHP-të, të planifikuara për periudhën afatmesme të planit aktual, janë pasqyruar në tabelat në vijim:

Tab. 3: Inv. e planifikuara në HHP-të në komunën e Kamenicës, zona urbane dhe rurale, periudha 2016-2018

Nr. ren.	Emri i HHP-së/investimet e planifikuara në hapësira të reja (opcionale)	2016	2017	2018	Burimi i investimeve
1	Mirëmbajtja dimërore dhe verore, rrenimet e objekteve të vjetra, sanimi i rrugëve dhe trotuareve	93.000,00	-	-	KK/Grant Qev./Donac
2	Pjesëmarrja në ndërtimin e kullës "Rexhep Malaj", Hogosht	190.000,00	-	-	Komunitet/ KK
3	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	25.000,00	-	-	KK
4	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja	35.000,00	-	-	KK
5	Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen "Malësia"	21.000,00	-	-	DEMOS
6	Rindërtimi i parkut të qytetit	22.139,18	-	-	UNDP
7	Mirëmbajtja dimërore dhe verore, rrenimet e objekteve të vjetra, sanimi i rrugëve dhe trotuareve	-	86.000,00	-	KK
8	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	-	30.000,00	-	KK
9	Asfaltimi i trotuareve Polici Shërbime Publike	-	8.946,00	-	DEMOS/KK

10	Asfaltimi i parkingut tek objekti i Komunës	-	10.577,21	-	DEMOS/KK
11	Ndërtimi i trotuarit Kam.-Beriv. LOT1	-	74.250,00	-	Të tjera
12	Rregullimi i HGJ në Hodonoc	-	10.726,00	-	DEMOS/KK
13	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja	-	40.000,00	-	KK
14	Mirëmbajtja dimërore dhe verore, rrënimet e objekteve të vjetra, sanimi i rrugëve dhe trotuareve	-	-	103.000,00	KK
15	Ndërtimi i trotuarit Kam.-Beriv. LOT2	-	-	74.250,00	Të tjera
16	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	-	-	73.000,00	KK
17	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja	-	-	40.000,00	KK
Gjithsej investime në HHP sipas viteve		386.139,18	260.499,21	290.250,00	Të kombinuara

Fig. 3: Investimet e planifikuara në HHP-të për periudhën afatmesme buxhetore 2016-2018



Gjetjet nga e kaluara tregojnë se buxheti komunal për projekte kapitale me gjithë efikasitetin e tij, nuk ishte burimi i vetëm për investime në HHP-të.

Në këtë kontekst, si dhe pas vlerësimit se gjendja e tanishme e shumicës së hapësirave ekzistuese në zonën urbane nuk është ajo e duhura, rekomandimet janë që për realizimin e investimeve në HHP-të nevojitet një qasje sistematike, dhe të njëjtat për periudhën e ardhshme afatmesme do të zhvillohen të orientuara në dy drejtime:

- Investimet në rehabilitimin/rivitalizimin e hapësirave ekzistuese, siç është parku tek QPS;
- Investimet në realizimin e projekteve të reja në fushën e HHP-ve, siç është hapësira në Berivojcë dhe ajo në zonën veriore të Kamenicës, etj.

Pjesë përbërëse të këtij plani mund të jenë edhe investimet në HHP-të pranë objekteve arsimore, gjegjësisht hapësirat pranë objekteve institucionale por edhe atyre banesore në qytet.

Gjate punës në grupe, shpeshherë është ngritur pyetja se çka konsiderohet investim kapital, çka rehabilitim e çka mirëmbajtje rutinore lidhur me HHP-të?

Të njëjtat, megjithëse në mënyrë relative, mund të definoohen si në vijim:

1. **Investimi** në hapësira të reja publike nënkupton rregullimin/ndërtimin e hapësirave, përfshirë punët përgatitore, nën mbikëqyrje profesionale bazuar në dokumentacionin teknik paraprakisht të përgatitur gjatë fazës së planifikimit.
2. **Rivitalizimi dhe rindërtimi** nënkupton punët/aktivitetet rregulluese/ndërtimore në hapësirat ekzistuese, me të cilat ndikohet në riparimin e elementeve të degraduara, në ndërrimin e atyre të dëmtuara plotësisht me qëllim të përmirësimit të funksionit, shfrytëzimit, sigurisë, dhe të komoditetit të hapësirave në përgjithësi, pa ndryshuar destinimin dhe pamjen e përgjithshme të hapësirës.
3. **Adaptimi** nënkupton punimet në hapësirat ekzistuese përmes së cilave mund të bëhen ndryshime të caktuara në organizimin e hapësirës, të zëvendësohen elemente të caktuara, të shtohen apo të reduktohen përmbajtje të ndryshme por vetëm në kuadër të hapësirës ekzistuese dhe pa e ndryshuar tërësinë e saj.
4. **Mirëmbajtja** rutinore nënkupton aktivitete të përsëritshme të cilat ndërmerren me qëllim të evitimit të degradimit të hapësirave dhe përmbajtjeve të ndryshme në to, përmirësimit të dëmtimeve, inspektime, pastrime, riparime, dhe në përgjithësi masa preventive më qëllim të mirëmbajtjes për shfrytëzim të HHP-ve.

3. VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË HHP-VE

Ashtu si projektimi urban, edhe strategjia e zhvillimit të hapësirave publike merret me hapësirat e hapura në qytet. Derisa strategjia e planifikimit urban nisët nga ambienti i ndërtuar, posaçërisht në qendra të qyteteve, strategjia e HHP-ve përqendrohet në ambientin e hapur natyror nga i cili zakonisht rrethohen ndërtesat. Ato ndërthuren pandashëm dhe hapësirat më të suksesshme janë gjithnjë ato të cilat përbëhen nga të dy këto elemente: ndërtimet dhe sipërfaqet e lira.

Njësitë e qeverisjes lokale në KK e shohin si të rëndësishëm planifikimin shumëvjeçar të investimeve kapitale. Në këtë kontekst, është me rëndësi të definohet edhe kahja drejt planifikimit të investimeve në HHP-të, si pjesë e rëndësishme e investimeve të përgjithshme.

Bazuar në konceptin e zhvillimit të territorit, përfshire edhe HHP-të, si objektiva të përgjithshme dhe në harmoni me PZhK-në dhe PZhu-në lidhur me HHP-të mund të përmenden:

- mbrojtja e hapësirave ekzistuese brenda dhe jashtë qytetit;
- rehabilitimi i hapësirave ekzistuese të degraduara;
- rregullimi i hapësirave të reja publike;
- zhvillimi i korridoreve të gjelberta, ndërtimi e rrugëve të reja dhe renovimi e atyre ekzistuese, krijimi i shtigjeve për këmbësorë, shtigjeve për biçikleta, tampone gjelbërimi tek zonat industriale, gjelbërime përgjatë rrugëve në zonat banuese, përgjatë rrugëve me trafik të dendur, etj.;

- reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik dhe krijimit të kushteve për lëvizje në këmbë dhe me biçikleta;
- ruajtja e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, etj.;
- ruajtja e peizazhit dhe zonave natyrore të mbrojtura;
- Në zonën qendrore të qytetit, përveç hapësirave të planifikuara parashihet edhe ngritja e dru-rendeve të reja, sipërfaqeve të vogla gjelbëruese, rregullimi i zonave për këmbësorë, etj., pa ndryshuar dhe duke tentuar përshtatjen me konceptin e organizimit të HHP-ve në PZhU.

Për dallim nga sektorët e tjerë, formimi i HHP-ve kërkon dekadacenie të punës së orientuar dhe zgjerimi i qytetit mund të vijenë në shprehje vetëm në terma afatgjate të planifikimit dhe pasi të jenë rregulluar zonat me ndërtime të paligjshmeinformale në kuadër të tij.

Dokumentet e nivelit lokal të planifikimit, bazuar në trendet e zhvillimit dhe të lëvizjeve të popullsisë deri në këtë moment, megjithatë janë treguar tej-ambicioze dhe në mospërputhje me parametrat reale të projektuara

3.1. Synimet dhe objektivat specifike

Synimi 1 - Rigjallërimi i HHP-ve ekzistuese

- **Objektivi 1:** Rindërtimi i parkut të qytetit me sipërfaqe prej 11.371,20 m² deri në fund të vitit 2016.
- **Objektivi 2:** Rindërtimi, gjegjësisht rivitalizimi i parkut tek QPS, me sipërfaqe prej 3.374,00 m² në fillim të vitit 2017.

Synimi 2 - Investimet në HHP-të e reja

- **Objektivi 1:** Planifikimi i HHP-ve përgjatë lumit të qytetit, gjegjësisht hartimi i Planit rregullues për brigjet e lumit.
- **Objektivi 2:** Ndërtimi i hapësirës gjelbëruese në Berivojcë gjatë vitit 2017.

Synimi 3 - Promovimi i HHP-ve

- **Objektivi 1:** Organizimi i diskutimeve publike me qytetarët për të marrë ide dhe propozime mbi zhvillimin e HHP-ve përfshirë krijimin e hapësirave të reja për periudhën afatmesme 2016-2020.

4. PLANI FINANCIAR

4.1. Supozimet kryesore në Planin financiar

Për krijimin e Planit investiv për komunën e Kamenicës është e nevojshme të përcaktohen disa supozime për projektimin e investimeve dhe fizibilitetin e përkryerjes së tyre, e të cilat janë:

- Përcaktimi i kërkesave investive i bazuar në nevojat për HHP;
- Mundësia e financimit të investimeve të planifikuara bazuar në burimet e financimit;
- Rrjedha e parasë për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga investimet e planifikuara është e bazuar në datën e përfundimit të ndërtimit të HHP-ve.

4.2. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale (buxheti investiv), përfshirë fuqinë punëtore, transportin, ndërtesat, pajisjet, automjetet, etj.

Investimet e planifikuara për periudhën 2016-2021 arrijnë vlerën prej 936.888,39 euro dhe janë kategori të kombinuara.

Është rekomandim i përgjithshëm që mënyra e planifikimit të investimeve në të ardhmen duhet të ndryshojë dhe të jetë e bazuar në projekte konkrete dhe në fusha të caktuara të HHP-ve, si:

- Parqe
- Gjelbërime
- Trotuare
- Parkingje
- Sheshe, etj.

Kjo, në mënyrë që planifikimi të jetë transparent por edhe që menaxhimi me investimet kapitale të jetë më i lehtë, praktik, dhe efikas.

Tab. 4: Projektet për investime kapitale

Viti i inv.	Përshkrimi i projektit investiv në HHP	Vlera investive	Burimi i financimit
2016	Rindërtimi i parkut, terreneve sportive dhe rindërtimi i rrugëve dhe trotuareve	386.139,18 €	Buxhet Komunal, DEMOS, UNDP
2017	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe sanimi i rrugëve dhe trotuareve	260.499,21 €	Buxhet Komunal/DEM-OS
2018	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe sanimi i rrugëve dhe trotuareve	290.250,00 €	Buxhet Komunal/Të kombinuara
Gjithsej vlera investive e planifikuar		936.888,39 €	Të kombinuara

Tab. 5: Analiza e zotimit të buxhetit për mirëmbajtje dhe investime kapitale

Viti i investimeve	Mirëmbajtja e HHP-ve ekzistuese	Vlera e planifikuar e investimeve kapitale	Buxheti i nevojshëm për mirëmbajtje dhe për investimet në HHP
2016	51.434,54 €	386.139,19 €	437.573,72 €
2017	53.234,75 €	260.499,21 €	313.733,96 €
2018	55.097,97 €	290.250,00 €	345.347,97 €
2019	55.097,97 €	-	55.097,97 €
2020	57.026,40 €	-	57.026,40 €
2021	59.022,32 €	-	59.022,32 €
Gjithsej	330.913,95 €	936.888,39 €	1.267.802,34 €


Për periudhën afatmesme të PMHHP-së dhe PIHHP-së, komuna e Kamenicës ka planifikuar rregullimin e HHP-ve dhe si rrjedhojë analizat financiare janë bërë vetëm për rregullimin e HHP-ve. Me krijimin e HHP-ve të reja, nevojitet të planifikohet buxhet për mirëmbajtjen e tyre në raport me sipërfaqet e shtuara dhe karakteristikat e HHP-ve të krijuara.

Tab. 6: Rrjedha e parasë për Investime Kapitale (IK) për vitin 2016

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Kosto mujore	0	0	39.575,00	44.575,00	50.110,00	58.860,00

Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Kosto mujore	58.860,00	54.660,00	44.125,00	35.375,00	0,00	0,00	386.139,18

Fig. 4: Rrjedha e parasë – investimet 2016




Tab. 7: Rrjedha e parasë për IK për vitin 2017

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Kosto mujore	0	0	8.982,00	23.315,00	36.3841,00	39.222,00

Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Kosto mujore	39.222,00	49.083,00	39.083,00	24.750,00	0,00	0,00	260.499,21

Fig. 5: Rrjedha e parasë – investimet 2017




Tab. 8: Rrjedha e parasë për IK për vitin 2018

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Kosto mujore	0,00	0,00	0,00	17.167,00	17.167,00	41.767,00

Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Kosto mujore	41.767,00	41.767,00	41.767,00	39.350,00	17.167,00	24.750,00	292.666,67

Fig. 6: Rrjedha e parasë – investimet 2018



5. MONITORIMI DHE RISHIKIMI

- Mbikëqyrja institucionale nga aspekti i planifikimit hapësinor, teknik dhe inventiv do të realizohet nga mbikëqyrësit profesionalë të caktuar nga autoriteti komunal përkatës. Procesi do të jetë i hapur dhe transparent për qytetaret dhe për komunitetin. Mbikëqyrja e zbatimit të projekteve përfshin vizitat në terren përgjatë dinamikës së zbatimit të projektit, të përcjella me raporte të rregullta periodike.
- Menaxhimi i ciklit të projektit me mësimet e nxjerra, përcjellje në detaje e fazave, përfshirë identifikimin, planifikimin, realizimin dhe pranim-dorëzimin e projektit.
- Mësimet e nxjerra nga të gjitha fazat e sipërpërmendura me rekomandimet për fazat pasuese të realizimit të projekteve në hapësirat e hapura publike, përfshirë rekomandimet për planifikimin e investimeve.
- Ngritja e kapaciteteve në planifikimin e mirë dhe në detaje të projekteve në veçanti, ngritja e kapaciteteve në hartimin e projekteve, përfshirë mirëmbajtjen e tyre nëpërmjet përshkrimit të detajuar të aktiviteteve duke synuar racionalizimin e investimeve.

5.1. Plotësimi dhe revidimi i PIHHP-së

Plotësimi i planit i referohet ndryshimeve të vogla në plan, të cilat mund të zënë vend sipas parashikimeve buxhetore për vitet pasuese. Revidimi i referohet ndryshimeve të mëdha dhe substanciale në PIHHP, si pasojë e ndryshimeve thelbësore të qëllimeve dhe objektivave. Revidimi është proces interaktiv dhe konsiston në hapat e njëjtë, si ata të aplikuar gjatë përpilimit të planit origjinal/fillestar për investimet në HHP-të.

a. Disa nga fushat të cilat janë lëndë e plotësimit të planit:

- Ndryshime të vogla në objektiva, strategji dhe politika të planifikimit të investimeve;
- Ndryshime eventuale në projektet e planifikuara, etj.

b. Metodologjia dhe hapat për t'u ndjekur në rast të plotësimit të PIHHP:

- Përgatitja e propozimit për plotësimin e planit. I njëjti mund të përgatitet nga zyrtarët përgjegjës për përgatitjen e PIHHP, nga shoqëria civile, komuniteti, qytetarët, etj.;
- Propozimi shqyrtohet dhe analizohet nga ana e drejtorive përgjegjëse, në këtë rast, Drejtoria për Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim dhe ajo për Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit
Një raport i dalë pas shqyrtimit të përmendur i paraqitet Komitetit për Planifikim (ndoshta edhe atij për politikë dhe financa) duke vënë në pah implikimet e përgjithshme të sqaruara në detaje, përfshirë:

- natyrën e plotësimit të PIHHP-së;
- qëllimin e plotësimit të planit;
- përcaktimin dhe përshkrimin e pjesës së planit të propozuar për ndryshim;
- arsyetimet mbi plotësimin e planit;
- metodologjinë e propozuar për ndryshimet dhe plotësimet në PIHHP.

6. PLANI I VEPRIMIT

Me qëllim të adresimit të drejtë të mungesave dhe praktikave joadekuate lidhur me investimet në HHP-të dhe me krijimin e hapësirave të reja, do të koncipohet një sistem veprimesh të nevojshme.

Veprimi 1: Nominimi i zyrtarit përgjegjës për monitorimin e PMHHP-së dhe PIHHP-së

Drejtoria për Financa, ajo e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor, si përgjegjëse për planifikim dhe investime në mjedis, do të kenë rolin udhëheqës në përcjelljen dhe realizimin e PIHHP-së. Mbajtja "zgjuar" e vetëdijes qytetare mbi rolin e HHP-ve në mirëqenien e përgjithshme dhe zhvillimin hapësinor të vendbanimeve.

Veprimi 2: Promovimi i HHP-ve - Përgatitja e broshurave dhe organizimi i prezantimeve publike

Broshurat dhe fletushkat do të jenë mjete të përhershme në promovimin e investimeve në HHP-të në qytetin e Kamenicës.

Veprimi 3: Organizimi i aktiviteteve me komunitetin

Aktivitete dhe debate publike do të organizohen në baza vjetore për të marrë kërkesa, komente dhe propozime nga qytetarët, në lidhje me ruajtjen e hapësirave ekzistuese, avancimin dhe krijimin e hapësirave të reja publike.

Veprimi 4: Ngritja e kapaciteteve në hartimin e planeve dhe projekteve sipas standardeve dhe ligjeve lokale dhe evropiane, me theks të veçantë në përgatitjen e dokumentacioneve investive teknike si dhe zbatimin e rekomandimeve ligjore në menaxhimin e kontratave.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Drejtoria e Financave dhe e Prokurimit publik janë përgjegjëse për monitorimin dhe rishikimin e planeve dhe projekteve.

Plani i veprimit mbi investimet e planifikuara në HHP-të për periudhën afatmesme 5- vjeçare

Tab. 9: Formë tabelare – model i planit të veprimit për investimet në HHP-të

Nr. ren.	Lista e projekteve për ndërgjegjësim	Statusi i HHP-së	2016	2017	2018	2019	2020
1	Materiale promovuese	N/A	Përpilimi, botimi dhe shpërndarja e broshurave për mirëmbajtjen e HHP-ve		Përpilimi, botimi dhe shpërndarja e broshurave për mirëmbajtjen e HHP-ve		
2	Ndërgjegjësimi publik për HHP	N/A	Organizimi i fushatave për ngritjen e ndërgjegjësimit publik	Organizimi i fushatave për ngritjen e ndërgjegjësimit publik			
Nr. ren.	Projekte, rivitalizim dhe krijim i HHP-ve	Statusi i HHP-së	2016	2017	2018	2019	2020
3	Rindërtimi dhe rivitalizimi i HHP-ve ekzistuese	HHP ekzistuese	Rivitalizimi i parkut të të qytetit deri në fund të vitit 2016				
4		HHP ekzistuese		Rivitalizimi i parkut tek QPS në fillim të vitit 2017			
5		HHP ekzistuese		Hartimi i Planit Rregullues Urban për zhvillimin e brigjeve të lumit të qytetit			

6	Investime në HHP të reja	Hapësirë e re	Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen Malësia. Punimet janë në zhvillim e sipër dhe pritet të përfundojnë në fund të vitit 2016.				
		Hapësirë e re		Asfaltimi i trotuareve Polici-Shërbime Publike			
		Hapësirë e re		Asfaltimi i parkingut tek objekti i Komunës			
		Hapësirë e re		Rregullimi i hapësirës gjelbëruese në Hodonoc			
					Ndërtimi i trotuarit Kamenicë-Berivojcë LOT1		
7			Hapësira ekzistuese dhe të reja	Sanime/rindërtime të trotuareve përgjatë rrugëve të qyteteve dhe fshatrave			Ndërtimi i trotuarit Kamenicë-Berivojcë LOT2
8				Rrëtime të obj. të ndërtuara pa leje, për ta liruar hapësirën publike	Sanime/rindërtime të trotuareve përgjatë rrugëve të qytetit dhe në fshatra		
9					Rrëtime të objekteve të ndërtuara pa leje, për t'i liruar hapësirat publike		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
CENTRA PËR SHËRBIM TË QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

U. 01 Nr. 41148
Br. 1

Nr. i faq. 1 Data: 28/12
Br. str. Datum: 2016
KAMENICËJA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më:28.12.2016

Duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 46.2 nënparagrafi b) të Statutit 01 Nr.005/26.09.2008 të Komunës së Kamenicës, nenit 12 paragrafi 12.2 nënparagrafi d), nenit 40 paragrafi 40.2 nënparagrafi b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisje Lokale si dhe Planit të Mirëmbajtjes (PMHHP) dhe Planit të Investimeve (PIHHP) në Komunën e Kamenicës Sh.09, Nr.34461 të dt.24.10.2016, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në seancën e mbajtur më 22.12.2016, miratoi këtë:

V E N D I M M B I

PLANIN E MIRËMBAJTJES DHE PLANIT TË INVESTIMEVE SH.09, NR.34461, DT.24.10.2016

1. Miratohet Plani i Mirëmbajtjes (PMHHP) dhe Plani i Investimeve (PIHHP) në Komunën e Kamenicës Sh.09, Nr.34461 të dt.24.10.2016.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Mirëmbajtjes (PMHHP) dhe Plani i Investimeve Sh.09, Nr.34461 e dt.24.10.2016 në Komunën e Kamenicës.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë DSHPAI dhe DUPH kurse për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi iu dërgohet:

- 1x1. Kryetarit të Komunës,
- 1x1. Kryesuesit të Kuvendit,
- 1x1. MAPL-së,
- 1x1.DSHPAI-së,
- 1x1.DUPH-së dhe
- 1x1. QShQ-Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Bajram Dërmaku

Plani për Investime
në Hapësirat e Hapura Publike
2016-2020
Komuna e Kamenicës



HELVETAS
Swiss Intercooperation

KOSOVO



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo